



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 7 PRILL 2016**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 7. APRILA 2016. GODINE**

**PRILL - APRILL
2016**

Rendi i ditës

1. Betimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, z. Hashim Thaçi

Dnevni red

1. Polaganje zakletve Predsednika Republike Kosova, Njegove ekselencije, g. Hashim Thaçi

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
E nderuar presidente e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga,
I nderuar president i zgjedhur i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi,
I nderuar kryeministër zoti Isa Mustafa,
Zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Greg Delavi,
I nderuar përfaqësues i Bashkimit Evropian, zoti Samuel Zhubogari,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të zyrave diplomatike në Republikën e Kosovës,
Të nderuara media,
Të nderuar të pranishëm në këtë seancë solemne.

Në rend dite kemi:

1. Betimi i Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, zoti Hashim Thaçi

E ftoj Presidentin e Republikës së Kosovës, të zgjedhur në seancën plenare më 26 shkurt 2016, zotin Hashim Thaçin, që ta bëjë betimin para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Urdhëroni, i nderuar president i zgjedhur!

PRESIDENTI HASHIM THAÇI: Betohem se tërë fuqinë time do t'ia kushtoj ruajtjes së pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, sigurimit të lirive dhe të drejtave njerëzore e qytetare, respektimit dhe mbrojtjes së Kushtetutës dhe ligjeve, ruajtjes së paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe me ndërgjegje e përgjegjësi do t'i kryej të gjitha detyrimet e mia. Betohem!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar President!

Tani e kemi procedurën e nënshkrimit.

(Duartrokitje)

Tani e kemi intonimin e himnit shtetëror të Republikës së Kosovës. Lus deputetët që të ngrihen në këmbë.

(Intonimi i himnit shtetëror)

(Duartrokitje)

E ftoj Presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që ta paraqesë fjalën përshëndetëse para deputetëve të Kosovës.

PRESIDENTI HASHIM THAÇI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
z. Kadri Veseli,
Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa,
Të nderuar zëvendësministra,
Të nderuar ministra,
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Delavi,
Përfaqësues i Bashkimit Evropian, zoti Zhbogar,
Të gjithë ju ambasadorë të nderuar dhe mysafirë e përfaqësues diplomatikë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Poštovani građani Republike Kosovo,

Sot është një moment i veçantë në jetën time.

Moment i krenarisë dhe përgjegjësisë.

Karriera ime politike dhe jetësore pasqyron zhvillimet nëpër të cilat ka kaluar Kosova në tri dekadat e fundit.

Jam angazhuar në të gjitha proceset që e kanë sjellë lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Jam i nderuar që jam pjesë udhëheqëse e të gjitha vendimmarrjeve për lirinë, pavarësinë dhe konsolidimin e shtetit modern të Kosovës.

Si kryeministër i vendit kam shërbyer me tërë energjinë për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Kosovën bashkërisht e kemi ndryshuar.

Tani do të jem në detyrë të re, me përgjegjësi të re.

Për një Kosovë të re, demokratike, evropiane dhe multietnike.

Kam shpresë dhe besim në vendin tonë dhe në qytetarët tanë.

Kam besim të plotë në institucionet e Kosovës, në Parlament, në Qeverinë e vendit.

Kam besim që do të vazhdohet me qeverisje të mirë.

Si president do të jem garant i respektimit të Kushtetutës dhe ligjeve, mbrojtës dhe përfaqësues i interesave të Kosovës.

Do të jem faktor unifikues politik dhe qytetar, përfaqësues i të gjithë qytetarëve, pa dallim etnie, feje, race dhe gjinie.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Më lejoni që ta falënderoj presidenten Jahjaga për punën e saj të shkëlqyeshme që e ka bërë në këto pesë vjet si simbol i unitetit politik dhe qytetar. Faleminderit e nderuar Presidente!

Do të punoj me tërë përgjegjësitë e mia që t'i afirmoj më tutje vlerat sublime të Deklaratës së Pavarësisë dhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Qëllimi dhe vizioni i qytetarëve të Kosovës është integrimi në Bashkimin Evropian, në NATO, si dhe miqësia e përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Do të punoj për kultivimin e mëtutjeshëm të të drejtave dhe lirive të njeriut, për reformat në drejtësi dhe luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, për reformat në arsim, shëndetësi, zhvillim ekonomik, për sjelljen e investitorëve të huaj në Kosovë.

Qytetarët e Kosovës meritojnë jetë të qetë, vende pune dhe mirëqenie sociale të standardeve evropiane.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Shteti i Kosovës është njohur nga 111 vende të botës.

Është anëtarësuar në shumë organizata rajonale dhe ndërkombëtare.

Në ditët në vijim presim rekomandimin për liberalizimin e vizave, ku qytetarët e Kosovës, si të gjithë evropianët, do të lëvizin lirshëm.

Do ta përmbyllin procesin e formalizimit për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës si forcë multietnike e standardeve euroatlantike. Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Shteti i Kosovës po afirmohet çdo ditë.

Kosova sivjet për herë të parë do të marrë pjesë në Lojërat Olimpike.

Po punojmë që sa më parë të anëtarësohemi në UEFA dhe në FIFA.

Të nderuar qytetarë,
Sot Kosova është faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon.

Kosova po zhvillon marrëdhënie të mira fqinjësore me të gjitha vendet e rajonit.

Shteti i Kosovës është i zotuar ta vazhdojë dialogun për normalizimin e plotë të marrëdhënieve me Serbinë.

Në këtë proces e kemi pasur dhe do ta kemi mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare.

Të dyja vendet dhe popujt tanë kanë të kaluar të hidhur ndërmjet vete.

Të kaluarën nuk mund ta ndryshojmë, por jemi të zotuar të mos e përsëritim.

Ta ndërtojmë të ardhmen, bazuar në vlerat tona tradicionale më të mira dhe standardet euroatlantike.

Të dyja vendet duhet të punojmë që të anëtarësohemi sa më shpejt në Bashkimin Evropian, duke e lehtësuar njëra-tjetrën, e jo duke e penguar.

Dialogu nuk ka alternativë, por tani ai duhet të ketë dinamikë dhe energji të re, vendimmarrëse dhe implementuese.

Si president i vendit, edhe sa i përket dialogut, do të punoj për ndërtimin e një konsensusi sa më të gjerë politik dhe qytetar.

Kosova do të punojë në mënyrë edhe më aktive për t'u bërë anëtare në nismat rajonale, evropiane dhe ato botërore.

Kosova do të punojë ngushtë me partnerët ndërkombëtarë që të bëhet anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Kosova është pjesë aktive e bllokut antiterrorist në botë.

Do të jemi të pakompromis në luftë kundër fundamentalizmit dhe çdo elementi ekstremist, kudo dhe kurdo që paraqitet.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Jam i vetëdijshëm se të jesh president i Kosovës është nder dhe përgjegjësi e madhe politike, kombëtare dhe kushtetuese.

Këtë detyrë zotohem se do ta kryej në bashkëpunim dhe komunikim të ngushtë me ju.

Ne jemi krenarë me të kaluarën tonë heroike.

Shumë breza u sakrifikuan për të ardhur këtu ku jemi sot.

Dhe ne sot kujtojmë përpjekjet për liri të presidentit Ibrahim Rugova dhe për sakrificën legjendare të komandantit Adem Jashari dhe gjithë dëshmorëve të lirisë.

Sot, nga ky vend, edhe një herë shprehim konsideratën më të lartë për të gjithë ata që u sakrifikuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar mysafirë,

Në angazhimet e mia do ta respektoj Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, traditën e mirë të qytetarisë, kriteret dhe vlerat euroatlantike.

Gjithmonë do të nisem nga oferta ime për dialog politik, ndërpartiak, për komunikim me shoqërinë civile, me mediet, biznesin dhe iniciativat e lira.

Si kreu i shtetit, do të ruaj, kultivoj dhe përfaqësoj unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

Ju faleminderit!

Hvala vam!

Teşekkürler!

Thank you!

(Duartrokitje)

KRYETARI: E Falënderojmë Presidentin për fjalën përshëndetëse dhe i urojmë marrjen e detyrës në emrin tim dhe të deputetëve: Zoti të ndihmoftë zoti President!

Në të njëjtën e falënderojmë edhe ish-presidenten e Republikës së Kosovës, zonjën Atifete Jahjaga: Faleminderit për shërbimin ndaj vendit!

Me këtë e përfundojmë këtë seancë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*